



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË KLUBEVE
SPORTIVE DHE OJQ- VE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1
Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të klubeve sportive dhe OJQ-ve të ndryshme të cilat kanë aplikuar sipas Ftesës publike për aplikim 1-111-7970 e dates 27.02.2017 (klubet sportive) , Ftesës publike për aplikim Nr-111-9512 e datës 06.03.2017 dhe Njoftimit për vazhdimin e afatit për aplikim Nr-111-9512/2 i datës 11.04.2017(OJQ-të), për ndarje të subvencioneve (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Gafurr Hetemi, Zyra e Kryetarit të Komunës, Kryesues
2. Vlora Krasniqi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
3. Ramiz Gashi , Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve të klubeve sportive dhe OJQ-ve të ndryshme të cilat kanë aplikuar sipas Ftesës publike për aplikim 1-111-7970 e dates 27.02.2017 (klubet sportive) , Ftesës publike për aplikim Nr-111-9512 e datës 06.03.2017 dhe Njoftimit për vazhdimin e afatit për aplikim për ndarje të subvencioneve Nr-111-9512/2 i datës 11.04.2017(për OJQ-të), brenda afatit prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesave në pajtim me dispozitat e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016 dhe legjislacionin në fuqi.

- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit
- Vendimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Mandati i komisionit është tre vjeçar.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 400 - 20305

Lipjan, më 20.04.2017

